

Lizingu

ÇKA QUAJMË "LEASING"?

Termi 'leasing' vjen nga fjala angleze 'lease' që do të thotë 'qira'.

Lizingu Financiar - nënkupton një marrëdhënie financiare në të cilën **Lizingdhënësi** hyn në një marrëveshje me shkrim me **Lizingmarrësin**, e cila i jep **Lizingmarrësit** të drejtën e posedimit dhe përdorimit të **Asetit Objekt Lizingu** (i përzgjedhur nga **Lizingmarrësi**) për periudhën e caktuar kohore, në këmbim të pagesës nga **Lizingmarrësi** të kësteve të përcaktuara.



Alternativë ndaj kredisë bankare

Lizingu është një mënyrë për financimin e nevojave tuaja për një objekt të caktuar (shtëpi, automjet apo pajisje, etj.) dhe është një alternativë ndaj kredisë bankare.



Kontrata e Lizingut duhet të bëhet në formë të shkruar në pajtim me procedurat e përcaktuara Ligjin Nr.03/L-103 PËR LIZINGUN dhe me Ligjin e BQK-së Nr. 04/L-093 PËR BANKAT INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE

Kontrata e Lizingut duhet të përmbajë:


- identitetin dhe adresat e palëve në Kontratën e Lizingut;
- identitetin e furnizuesit.
- përshkrimin e Asetit Objekt Lizing;
- kohëzgjatja e afatit të Lizingut;
- shumën totale të të gjitha pagesave për t'u paguar nga Lizingmarrësi;
- numrin, shumat dhe afatet e çdo pagese periodike;
- mënyrën e transferimit të pronësisë në rastet e lizingut financiar.



Lizingu financiar gjithmonë i nënkupton tri palë të interesit:



Lizingdhënësi - nënkupton një subjekt juridik të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës për të ushtruar në mënyrë të ndërsjellët transaksionet e Lizingut Financiar dhe/ose Lizingut Operativ dhe i cili jep Lizingmarrësit të drejtën e posedimit ose të shfrytëzimit të Asetit Objekt Lizingu në bazë të Kontratës së Lizingut.



Asete Objekt Lizingu- mund të jenë:
Vetura për pasagjerë dhe automjete të lehta komerciale;
Banesa dhe shtëpi;
Lokale afariste;
Kamionë të lehtë, kamionë dhe rimorkio;
Autobusët;
Pirunjerët dhe mjetet ndërtimore;
Mjetet Agro;
Pajisjet e printimit, IT-së dhe Telekomunikacionit;
Pajisjet Mjekësore;
Makinat e përpunimit dhe procesimit CNC;
Makineritë e ndërtimit, makineri të tjera të lehta dhe makineri të tjera të rënda, etj.



Lizingmarrësi - nënkupton një person fizik ose juridik, i cili përfiton të drejtën e posedimit dhe shfrytëzimit të **Asetit Objekt Lizingu** nga **Lizingdhënësi** në bazë të **Kontratës së Lizingut**.
Lizingmarrësi përcakton **Asetin Objekt Lizingu** dhe zgjedh **Furnizuesin**. Gjatë periudhës së shlyerjes, si **Lizingmarrësi**, ka të drejtë ekonomike mbi **Asetin Objekt Lizingu**, ndërsa **Lizingdhënësi** mbetet pronari ligjor. Me shlyerjen e kështit përfundimtar dhe kalimin e pronësisë, **Lizingmarrësi** bëhet pronar i **Asetit Objekt Lizingu**.



Lizingu operativ - Aseti Objekt Lizingu i jepet **Lizingmarrësit** në përdorim për një periudhë të caktuar dhe pas skadimit të kontratës **Lizingmarrësi** ia kthen **Lizingdhënësit**..



Kur përdoret Lizingu operativ?

- Kur **Lizingmarrësi** ka nevojë për qasje të shpejtë dhe fleksibile në asete, dhe nuk ka interes për të mbajtur asetet për një periudhë të gjatë;
- Për pajisje që kanë cikle jetëshkurta, si pajisjet teknologjike dhe kompjuterike, që shpejt bëhen të vjetra ose të pazbatueshme për shkak të trendeve inovative.

Lizingu financiar - Aseti Objekt Lizingu i jepet në përdorim **Lizingmarrësit** për një periudhë të caktuar dhe pas skadimit të kontratës, **Lizingmarrësit** mund t'i kalojë e drejta e pronësisë mbi asetin.



Kur përdoret Lizingu financiar?

- Kur **Lizingmarrësi** ka synimin të bëhet pronar i asetit pas përfundimit të marrëveshjes së lizingut.

Karakteristikat e Lizingut:

- Financimi miratohet gjithmonë për një **Aset Objekt Lizingu** të caktuar;
- Prokurimi i asetit kryhet nga **Lizingdhënësi** dhe jo nga **Lizingmarrësi**;
- **Lizingdhënësi** është pronar i asetit gjatë gjithë afatit të kontratës së lizingut;
- **Aseti Objekt Lizingu** është në të njëjtën kohë kolateral;
- **Aseti Objekt Lizingu** mund të jetë i siguruar nga një policë sigurimi për kohëzgjatjen e marrëveshjes.